



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**  
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

## **KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI**

### **INFORMATË PËR AKTIVITETET E KËSHILLIT KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI-KKSB PËR VITIN 2019**

Bazuar në nenin 9 parag. 1.8 të Udhëzimit Administrativ nr. 27/2012 MPB – 03/2012 MAPL, për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, KKSB informon për punët dhe aktivitete për vitin 2019.

Në informatë janë përfshirë në mënyrë të përmbledhur, takimet e KKSB-së, me tema në fusha të caktuara, të cilat paraqesin objektivat dhe zbatimin e Planit vjetor të punës së Këshillit. Të gjitha temat e planifikuara me Planin e punës janë diskutur gjatë vitit. Në vitin 2019 KKSB ka mbajtur katër (6) takime.

Përmbledhje e punëve dhe aktiviteteve, si vijon:

#### **Mbledhja e parë, mbajtur më 19 shkurt 2019**

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës.

Temat:

#### **1. Raporte të Policisë së Kosovës dhe KFOR-it për gjendjen e sigurisë në Komunë**

**z. Bekim Bislimi**, theksoi, gjendja e sigurisë në Komunë vlerësohet e qetë dhe stabile dhe nuk pritet që të eskaloj as në të ardhmen. Jemi në fillim të vitit dhe kemi bërë një analizë në përgjithësi të gjendjes me qëllim të ndërmarrjes së hapave parandalues, për përmirësimin e gjendjes. Në këtë periudhë krahasuar me atë të vitit të kaluar ka trendë të rënies sa i përket rasteve të raportuara dhe iniciuara nga ana jonë. Sa i përket veprave të dëmtimit të pronës, vjedhjeve dhe vjedhjeve të rënda kemi rënie afër 100%, ndërsa gjendja në komunikacion është e njëjtë sa i përket aksidenteve të raportuara. Në këtë periudhë ngritje kanë shënuar rastet e dhunës në familje, ku kemi bërë një analizë të rasteve të kësaj natyre dhe kemi ardhë në përfundim se te ato familje dhuna ka ekzistuar edhe më parë, por se nuk ka ekzistuar gatishmëria për ti raportuar,

ndërsa faktorët shtytës pothuajse janë të njëjtë. Jemi në kontinuitet të zbatimit të disa planeve operative me qëllim të parandalimit të disa veprave të cilat cenojnë rendin dhe sigurinë në përgjithësi, kemi identifikuar dhe arrestuar disa persona të dyshuar për vjedhje të rënda, janë gjetur dhe konfiskuar një sasi e konsiderueshme e mjeteve të punës të cilat u janë kthyer pronarëve të ligjshëm. Jemi duke punuar në përmirësimin e gjendjes në komunikacion. Aktualisht jemi me plan konkret, në bashkëpunim me Drejtorinë e Inspeksionit për parandalimin e taksive ilegale që operojnë në Komunën e Podujevës. Sa i përket sigurisë në objektet shkollore përgjithësisht është e qetë, me përjashtim të një rasti të raportuar "lëndim" në shkollën "Dëshmorët e Kombit". Dua të theksoj se kemi bashkëpunim të mirë me Drejtorin e Drejtorisë së Arsimit dhe me stafin udhëheqës të shkollave

**Përfaqësuesi i KFOR-it**, theksoi, gjendja e sigurisë së përgjithshme dhe e qarkullimit të lirë, nga ana e KFOR-it vlerësohet e qetë dhe stabile. Bazuar edhe në raportin e paraqitur nga Komandanti i Policisë gjendja është në trendë pozitiv sa i përket veprave kriminale.

**z. Naim Bajraktari**, theksoi, që tani jemi duke i marrë kompetencat, ndërsa bashkëpunimi do të thellohet edhe më tutje në të gjitha sferat, që është një lajmë i mirë që i shërben edhe më shumë sigurisë.

**z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës**, gjithashtu uroj formimin e Ushtrisë së Republikës së Kosovës, për ngritjen e kapaciteteve dhe profesionalizimin e saj.

## **2. Miratimi i propozimit të Planit të punës të KKSBB-së për vitin 2019**

### **Informata për aktivitetet KKSBB-së në vitin 2018**

#### Konstatim:

*Propozimi i Planit të punës së KKSBB-së për vitin 2018, pas votimit njëzëri rekomandohet për miratim në Kuvendin e komunës, me plotësim: Informata nga FSK-së për sigurinë në komunë, në çdo takim të Këshillit.*

*Informata për punët dhe aktivitete e KKSBB-së për vitin 2018 u kalua pa vërejtje dhe e njëjta procedohet në Kuvendin e komunës.*

## **Mbledhja e dytë, mbajtur më 30 prill 2019**

Në mungesë të Kryetarit të Komunës z. Agim Veliu, mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës.

Temat:

### **2. Raporti i Policisë së Kosovës për gjendjen e sigurisë në komunë**

**- Informata nga përfaqësuesi i KFOR-it për sigurinë në komunë**

**- Informata nga përfaqësuesi i FSK-së për sigurinë në komunë**

**z. Bekim Zogiani**, ky është takimi im i parë në KKSBB, sa i përket situatës së sigurisë në Komunën e Podujevës, nga data e mbajtjes së takimit të fundit të Këshillit gjendja e sigurisë në përgjithësi është e qetë. Gjatë muajit mars dhe prill janë të raportuara 205 raste të ndryshme kriminale, prej tyre 32 raste janë zbuluar dhe janë proceduar në procedura të mëtejme. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, kemi një ngritje të lehtë, 6 raste më shumë. Prej kohës kur kam marrë detyrën, nga data 8 prill të këtij viti, kemi filluar me një analizë të përgjithshme të përgjegjësisë, të situatës, krimeve etj. çështje të cilat i preokupojnë edhe banorët e Komunës së Podujevës dhe Policinë. Si çështje ende më problematike kemi atë të trafikut, për shkak edhe të

rrugëve, parkingjeve, aksidenteve. Gjatë vikendit në fshatin kërpimëh kemi pas një aksident, si pasojë një person ka pësuar me fatalitet dhe të tjerët me lëndime të rënda. E kemi si prioritet angazhimin e Njësisë policore në akset rrugore më të rrezikshme, ku planifikojmë pika kontrolluese me radar dhe çështje tjera që ndërlihen me sigurinë e trafikut.

Gjatë kësaj periudhe i kemi pasur 9 plane operative në fuqi, janë shqiptuar gjithsejtë 231 gjoba në trafik, numri i veturave të konfiskuara është 81, pastaj 15 raste të armëve të konfiskuara. Megjithatë mund të themi se situata është e qetë dhe nuk ka ndonjë indikacion për prishjen e rendit dhe qetësisë në të ardhmen.

Pasi që jemi në muajin e shenjtë të Ramazanit me Kryetarin e Këshillit të bashkësisë Islame kemi pasur një takim javën e kaluar dhe do të jemi në kontakt vazhdimisht në mënyrë që edhe ky muaj të kalojë në mënyrën më të mirë.

**Përfaqësuesi i KFOR-it** Nga perspektiva e KFOR-it gjendja e sigurisë së përgjithshme në Komunën e Podujevës është e mirë, situatë e qetë dhe stabile sikurse e potencoi edhe Komandanti i Stacionit të Policisë.

**z. Naim Bajraktari**, gjatë periudhës së kaluar kemi rishikuar pikat që mund t'i konsiderojmë si më të rëndësishme për vlerësimin e rreziqeve eventuale, siç janë: digat, objektet e rëndësishme së veçantë, Ujësjellësi rajonal, shkollat, spitalet, urat, lumenjtë, rrugët, hekurudhat, ndërtesat e larta, pompat e derivateve të naftës etj.. Në kuadër të këtij domeni, gjatë kësaj periudhe kohore, në bashkëveprim me autoritet komunale kemi testuar kapacitetet dhe aftësitë tona të përbashkëta profesionale në raste emergjente përmes ushtrimit fushor treditor i quajtur “ Skifteri 3”, ku kemi parë se kemi një bashkëpunim të shkëlqyer ndërinstytucional.

**z. Gëzim Namani**, Stacioni i Policisë në të kaluarën kishte mungesë të personelit. Si qëndron tani puna dhe a ka tendencë të rritjes së numrit të zyrtarëve policor.

**z. Bekim Zogiani**, situata sa i përket zyrtarëve policor pothuajse është e njëjtë, nuk është gjendje e mirë. Në zhargonin policor llogariten rreth 10 njësi patrulluese. Duke marrë parasysh edhe moshën ku 80% e stafit janë mbi moshën 45 vjeçare do të thotë që me të vërtetë është një sfidë. Shpresojmë se me përfundimin e gjeneratës së re në Vushtrri, të na vijë një numër i caktuar në bazë të strukturës që është aprovuar. Numri i përgjithshëm i stafit në Stacionin e policisë në Podujevë është 101.

**z. Faik Muçiqi**, theksoi, kohë më parë kemi parë kthimin e një numri të qytetarëve të Kosovës nga Siria. A keni informacione se a ka banorë të Komunës tonë. Kjo është ngjarje e mirëpritur e kthimit, por si qëndron çështja e akomodimit të tyre dhe trajtimi i tyre institucional.

**z. Bekim Zogiani**, në bazë të raporteve që disponojmë dhe vendimet e gjykatës në zonën e Komunës së Podujevës i kemi tre persona të gjinisë femërore të cilat me vendim të gjykatës janë në arrest shtëpiak.

**z. Osman Kurtolli**, sa i përket qytetarëve të kthyer nga Siria në këtë e mirëpresim, por dua të theksojë se është fat i mirë që nuk kanë të bëjnë asgjë me Bashkësinë Islame. Bashkësia Islame do të ketë parasysh sjelljet dhe reagimet e tyre dhe në këtë aspekt do të jetë në koordinim me institucionet relevante. Deri më tani nuk janë vërejtur kurrfarë shenjash apo tendenca negative.

### **3. Informatë për sigurinë në shkolla dhe masat për ngritjen e sigurisë**

**z. Agim Blakçori**, theksoi, shikuar në përgjithësi dhe duke u bazuar në raportet e Policisë dhe raportet e shkollave si dhe raportet e DKA-së në lidhje me sigurinë në shkolla, mund të themi se në këtë vit shkollor gjendja e sigurisë në shkollat e Komunës së Podujevës është e qetë, stabile dhe e sigurt. Në funksion të sigurimit të një mjedisi të qetë dhe të sigurt në institucionet shkollore,

Drejtori i DKA-së ka mbajtur mbledhje me të gjithë drejtorët e shkollave, ku janë trajtuar temat: -Siguria në shkolla-masat për parandalimin e dhunës në shkolla ; -Fuqizimi i organeve udhëheqëse dhe profesionale në shkolla, ku kemi dalë me disa rekomandime për zbatim të vitit shkollor 2018/2019. Drejtori ndër tjera foli për fuqizimin dhe funksionalizimin e plotë të organeve qeverisëse-udhëheqëse dhe profesionale të shkollave. Drejtori gjatë prezantimit të informatës në detaje pasqyroi të gjitha çështjet që kanë të bëjnë dhe ndërlidhen me sigurinë në shkolla: për sigurimin e transportit të nxënësve, për ndërtimin dhe renovimin e objekteve shkollore, rrethojat e oborreve të shkollave, ndërtimin dhe rregullimin e trotuareve për këmbësor me ç'rast kërkoi nga Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit që gjatë planifikimeve për ndërtimin e trotuareve të vazhdojë t'u jap përparësi rrugëve që shpijnë për në shkolla, pastaj me theks foli për bashkëpunimin me Stacionin e Policisë në Podujevë, ku e vlerësoi një bashkëpunim të ngushtë duke bashkërenduar veprimet dhe aktivitetet e ndryshme; nevojën për instalimin e kamerave të sigurisë në shkolla, ku veçse janë duke u zhvilluar procedurat tenderuese për këtë projekt. Shkollat përfituese të këtij projekti do të jenë Gjimnazi "Aleksandër Xhuvani", SHMLT "Fan S. Noli", SHMLE "Isa Boletini", SHFMU "Dr. Ibrahim Rugova", SHFMU "Shaban Shala", IP "Armela". Si sfida drejtori përmendi incidentet dhe zënkat ndërmjet nxënësve, dëmtimet në objektet e disa shkollave nga persona të panjohur pas përfundimit të orarit mësimor, lokalet afër shkollave, qentë endacak, komunikacionin, trotuaret, mungesa e kamerave të sigurisë në shkolla, mungesa e rojës në shkolla.

**z. Bekim Zogiani**, theksoi, Policia e Kosovës është duke mbajtur ligjërata nëpër shkolla me temat për substancat narkotike dhe për pasojat që shkaktohen nga përdorimi i saj. Deri më tani ligjëratat i kanë ndjekur 1304 nxënës, më pastaj kemi planifikuar edhe tema tjera të ndryshme. Kemi kërkuar që së bashku me Drejtorinë e Arsimit ta mbajmë një takim me këshillin e Prindërve para përfundimit të këtij viti. Sa i përket Policisë disa prej tyre i kemi të angazhuar në rroba civile që kujdesen për çështjen e sigurisë nëpër shkolla

**z. Faik Muçiqi**, kemi ndërtuar trotuare të shumta afër shkollave dhe rrugëve që shpijnë në shkolla dhe jemi duke vazhduar në ndërtimin e tyre. Drejtori në detaje foli për lokacionet ku janë ndërtuar trotuaret. Sa i përket qenve endacak, ky problem vitin e kaluar është trajtuar nga Niveli Qendror, mirëpo si duket ky ishte një plan me kohë të caktuar dhe pas përfundimit nuk ka vazhduar. Çështja e qenve endacak vazhdon të jetë problematike dhe shqetësuese. Lidhur me këtë u kemi drejtuar me shkresa disa herë autoriteteve qendrore, ku i kemi paraqitur shqetësimet tona, gjendjen aktuale dhe pasojat nga qentë endacak dhe si përgjigje na është kthyer se ende nuk kanë ndonjë buxhet shtesë për të vazhduar me trajtimin e tyre, ndërsa Komunitet me buxhetin që kanë nuk mund të bëjnë trajtimin e tyre

**z. Nuhi Selimi**. Ne si banorë të fshatit Orllan na shqetëson rruga, ka vozitje të shpejta, kemi bërë disa kërkesa për vende të pengesave në rrugë, në veçanti të shkolla dhe përtej objektit të postës. Edhe sa i përket trotuarit ka problem, kërkesa është dhe ka qenë për shtrirje të trotuarit të ura, sepse është shumë i nevojshëm, në veçanti për nxënësit, përndryshe qarkullimi nëpër urë është shumë i rrezikshëm.

**znj. Donjetë Sheqiri**, është bërë dukuri dhe po krijohen mundësitë që nxënësit të konsumojnë duhanin, por gjithashtu edhe pije tjera alkoolike për shkak të lokaleve që ekzistojnë sidomos të shkollat e mesme, duke mos përjashtuar edhe substancat narkotike.

**z. Osman Kurtolli**, fshati Shajkoc dhe fshati i Bajçinës janë fshatrat me qarkullimin më të madh të automjeteve në nivel të Komunës, kështu që vendosja e pengesave është shumë e nevojshme. Te shkolla dua të përmend një fushë të sportit e cila është ndërtuar nga mërgata shqiptare nga

fshati ynë, është e nevojshme ndërtimi i një trotuari përballë shkollës, duke marrë parasysh lëvizjen e nxënësve që është jashtëzakonisht e madhe.

**z. Liman Zeqiri**, theksoi, sikurse jeni në dijëni fshati Kaqybeg fare nuk ka objekt shkollorë dhe çështje problematike është që nxënësit nga ky fshat vijnë në mësimet në shkollat e fshatit Batllavë dhe atë të fshatit LLugë dhe ajo pjesë e rrugës është pa trotuare, një gjatësi shumë e madhe.

#### **4. Informatë për dinamikën e realizimit të projektit të vendosjes së kamerave të sigurisë**

**z. Gëzim Namani**, theksoi, sa i përket projektit në fjalë procedurat tenderuese veç se kanë përfunduar, është përzgjedhur operatori dhe projekti ka filluar sipas planit dinamik. Drejtori informoi saktësisht edhe për pikat ku është filluar me instalimin e rrjetit dhe vendosjen e kamerave. Nënvizoi, për shkak të punimeve në rrugën “Zahir Pajaziti”, do të vazhdojmë me projektin në rrugët anësore të qytetit. Të gjitha hyrjet dhe daljet e qytetit do të mbulohen me kamera. Sistemi është i cilësisë së lartë, ndërsa monitorimi i takon Stacionit të Policisë, ku kërkohet edhe personel i veçantë, i trajnuar.

### **Mbledhja e tretë, mbajtur më 26 qershor 2019**

Në mungesë të Kryetarit të Komunës z. Agim Veliu, mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës.

Temat:

#### **1. Raporti i Policisë së Kosovës për gjendjen e sigurisë në komunë**

- **Informatë nga përfaqësuesi i KFOR-it për sigurinë në komunë**

- **Informatë nga përfaqësuesi i FSK-së për sigurinë në komunë**

**znj. Antigona Çitaku Dibrani**, theksoi, gjendja e sigurisë në Komunë, vlerësohet e qetë pa ndonjë tendencë të përkeqësimit apo ngritjes së shkallës së kriminalitetit. Gjatë muajit maj të raportuara kanë qenë gjithsejtë 87 raste, ndërsa nga data 1-25 qershor kemi 55 raste të raportuara, do të thotë kemi ulje të shkallës së raportimit të rasteve. Sa i përket planeve operative, Stacioni Policor ka në implementim një mori planesh operative, siç janë; për sigurinë në komunikacion, për tollovitë e ndryshme nëpër sportele të bankave dhe institucione të ndryshme, për parandalimin e të shtënave në ahengje dhe dasma, për arrestimin e personave të kërkuar nga gjykata, ku me zbatimin e këtij plani jemi duke u treguar më të suksesshmit në rajon, etj. Nga ky vikend do të angazhohemi për implementim të Planit operativ në parandalimin e të shtënave në ahengje dhe dasma dhe do të vazhdojmë deri në përfundim të sezonit veror. Nga data 06 maj kemi filluar me implementimin e projektit për vetëdijesimin e qytetarëve nga rreziqet e zjarreve të ndryshme, ku janë mbajtur takime në fshatrat Kërmimeh dhe Orllan, pra janë mbajtur ligjërata për vetëdijesimin e banorëve në luftimin e kësaj dukurie. Sa i përket rasteve të dhunës në familje, në rajonin e Komunës së Podujevës ka raste të ngritjes së lehtë të dhunës në familje. Ne i kemi bërë analizë të gjitha rasteve të raportuara. Në muajin maj 2018 kanë qenë 6 raste, ndërsa në qershor 2018 kanë qenë 4 raste. Në muajin maj 2019 kanë qenë 6 raste, ndërsa në qershor 9 raste të raportuara. Rastet janë proceduar. Sa i përket Strategjisë së trajtimit të rasteve të dhunës në familje Policia aplikon pakon e viktimave, ku secila viktimë shërbehet me pako. Nga analizat e bëra të këtyre rasteve, rezulton se realisht nuk kemi të bëjmë me shtim të numrit të rasteve të dhunës në familje, të gjitha 9 rastet janë që datojnë me vite, por që viktimat nuk i kanë raportuar. **Përfaqësuesi i KFOR-it**, theksoi, nga pikëpamja e KFOR-it gjendja e sigurisë vlerësohet e qetë dhe stabile, nuk kemi diçka për të raportuar.

**z. Nexhmi Rudari** kërkesat e tilla për investime në projekte mund t'i bëni në drejtoritë përkatëse. KKSB nuk ka mandatin e miratimit të kërkesave për realizim të projekteve, por sidoqoftë këtë e shohim si një çështje të ngritur.

**z. Faik Muçiqi**, një aksion i mirëpritur i policisë, emergjencave, inspektorëve dhe akterëve tjerë që gjatë muajit të kaluar dhe këtë muaj në tërë territorin e Komunës kanë dalë për të bërë evidentimin e gropave të cilat janë krijuar nga faktorë të ndryshëm. Disa prej tyre janë krijuar nga kompani të ndryshme nga nxjerrja e materialit, disa janë identifikuar si grupa personale, etj. Gropa te Miniera e fshatit Herticë që cilësohet si problem i Agjencionit për Miniera dhe Minerale, është shkaktuar nga hulumtimet dhe nuk është kthyer në gjendjen e mëparshme, kjo është përgjegjësi institucionale dhe ne e kemi adresuar kërkesën për mbyllje.

## **2.Masat parandaluese kundër djegieve të pyjeve (Koordinimi i aktiviteteve në mes DBPZHR,DSHPMSH,SHZSH, Policisë, Agjencionit Pyjor, Agjencionin e Menaxhimit Emergjent si dhe sensibilizimi i qytetarëve për pasojat nga zjarri gjatë periudhës së korrje-shirjeve**

**z. Vezir Januzi**, theksoi se nga data 13.07.2010 kompetencat në mbrojtjen e pyjeve kanë kaluar në Komunë, konkretisht në DBPZHR, ndërsa punët profesionalo-teknike i kryejnë zyrtarët nga Drejtoria Koordinuese Rajonale e APK-së në Prishtinë.

Gjatë sezonit veror APK-ja për çdo vit angazhon punëtorë sezonal të cilët intervenojnë në rastet kur paraqiten zjarre pyjore kurse kohën tjetër angazhohen në pastrime dhe rrallime parakomerciale. Gjatë periudhës 11.03.2018 - 23.04.2018 kemi pasur 11 raste të shfaqjes së zjarreve me intensitet të ulët, të mesëm dhe të lartë që kanë përfshi një sipërfaqe prej 26.10 ha, ndërsa këtë vit vetëm gjatë muajit mars kemi pasur 47 raste të zjarreve pyjore ku janë përfshi 414.45 ha. Çdo vit nga APK-ja hartohet Plani Menaxhues.

Gjatë vitit kalendarik është e paraparë që çdo teren të kontrollohet d.m.th. të regjistrohet së paku një herë e sipas nevojës edhe më shumë. Deri më tani janë kryer regjistrime në dy terrene. Me kërkesa të Njësisë hetimore nga Stacioni policor i Podujevës kemi dalë në gjashtë (6) raste për vlerësime të dëmeve pyjore në prona private si pasojë e vjedhjes së masës drunore nga persona të huaj. Aktualisht është duke u zhvilluar procedura për shpalljen e tenderit për disa ngastra pyjore për shitjen e masës drunore në këmbë, masë drunore e cila është damkosur nga APK-ja dhe e lejuar për prerje me Plan Menaxhues për vitin 2019.

Sa u përket pyjeve private, pronarët e pyjeve private me ligj kanë të drejtë aplikimi për prerje pylli nga muaji janar-mars për çdo vit kalendarik. Kërkesat e tyre përcjellën në Drejtorinë Rajonale Koordinuese të APK-së në Prishtinë ku zyrtarët/ekspertët e fushës bëjnë shqyrtimin e tyre në teren e pastaj ato kthehen në DBPZHR e cila i përgatit lejet për prerje pylli. Këtë vit nga pronarët e pyjeve private janë parashtruar 322 Kërkesa për prerje pylli, deri më tani nga zyrtarët e APK-së janë shqyrtuar 44, ndërsa taksë për shërbime në pyje private është paguar për 35 prej tyre dmth. janë lëshuar 35 leje për prerje pylli.

Nga kontrollet e zhvilluara nga stafi i sektorit, Inspektorati pyjor dhe Policia kufitare deri më tani janë konfiskuar 128.28 metër<sup>3</sup>.

**z. Faik Muçiqi**, informoi të pranishmit për punët dhe aktivitetet e Shërbimit të Zjarrfikësve lidhur me intervenimet dhe masat parandaluese kundër zjarreve. Theksoi, nga muaji janar deri në ditën e djeshme janë bërë 380 intervenime, prej tyre 354 janë zjarre, të tjerat kanë qenë në aksidente, evakuime etj. Nga lajmërimet ka qenë vetëm një informatë e rrejshme që nënkupton për ngritje të vetëdijesimit të qytetarëve. Muaji i prillit ka qenë periudha ku në masë ka pas raste të djegies së pyjeve ku shihet edhe nga raporti i zjarrfikësve, 245 kanë qenë intervenime

kryesisht në pyje. APK gjithashtu ka angazhuar një kontingjent për intervenime gjatë këtij sezoni. Krahas kësaj me Policinë e Kosovës Shërbimi i Zjarrfikësve çdo vikend kanë njësi patrulluese në liqenin e Batllavës.

### **3.Informatë dhe diskutim për projektet (të infrastrukturës dhe të shërbimeve) që ndikojnë në sigurinë e qytetarëve, që mund t'i propozohen drejtorive për miratim në Kuvendin Komunal, gjatë periudhës së miratimit të buxhetit të komunës**

**z. Nexhmi Rudari Nënkyetar i Komunës**, në fjalën hyrëse përmenda disa planifikime ose prioritete të dala edhe nga Këshilli, që ndikojnë në sigurinë e qytetarëve. Sikurse jeni të informuar jemi në proces të instalimit të kamerave të sigurisë në qytet por nuk do të thotë se vetëm kjo pjesë do të duhej mbuluar me kamera apo me ndriçim publik. Nuk kemi të dhëna të sakta por në lagjet ku ka ndriçim publik jam shumë i bindur ka edhe rënie të aktiviteteve kriminale. Drejtoritë përkatëse i kanë bërë draftet e para të planifikimit të buxhetit, por deri në muajin shtator kur edhe përfundon afati kohor për planifikim të buxhetit, nëse ka ndonjë projekt që do të mund të ndikonte drejtpërdrejtë në sigurinë e qytetarëve atëherë do të ishte mirë që edhe KKSB të ketë propozime.

**z. Osman Kurtolli**, theksoi, është një shqetësim i imi për faktin se Komuna jonë i përket një regjioni, atë të Prishtinës që ka rreth 600,000 banorë. Mendimi im është që kjo reflekton edhe në çështjen e sigurisë publike. Fjala vjen mungesa e numrit të personelit policor rezulton nga kjo. Kjo reflekton edhe te Bashkësia Islame, apo kur kemi të bëjmë me numrin jo të mjaftueshëm të rojeve të pyjeve, apo te të ardhurat të cilat burojnë te Komuna jona shkak është ky, sepse regjioni është shumë i madh që përfshinë 1/3 e territorit të Kosovës.

**z. Liman Zeqiri**, theksoi, kam një shqetësim lidhur me çështjen e ambientit. Problem jo vetëm te ne por edhe në regjion janë ujërat e zeza. E di që projekti ka një kosto të lartë, por mundësisht të shqyrtohet dhe të parashihet për vitet e ardhshme, sepse e dimë që impiantet kanë një kosto jashtëzakonisht të lartë, por mundësisht që kjo të parashihet në të ardhmen, që ujërat e zeza të hiqen prej lumenjve sepse është shqetësim edhe i banorëve.

**z. Nexhmi Rudari** ne jemi në fazën e fillimit të ndërtimit të kolektorëve, projekt i cili do të realizohet me kredi nga Ministria e Financave të Austrisë dhe Banka Austriake. Të gjitha procedurat janë përmbyllur si në Kuvend ashtu edhe në Qeveri dhe shumë shpejtë pritet të filloj ndërtimi i kolektorëve që do të grumbullojnë të gjitha ujërat e zeza që aktualisht derdhen në lumenjtë në territorin e Komunës së Podujevës.

**z. Qefser Behrami**, theksoi, nëse ka mundësi që në planifikim të buxhetit të parashihet vazhdimi i shtrirjes së rrjetit të ndriçimit në rrugën në fshatin Kërpimëh.

### **Mbledhja e katërt, mbajtur më 26 shtator 2019**

Në mungesë të Kryetarit të Komunës z. Agim Veliu, mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës.

**z. Nexhmi Rudari**, Në takim kemi edhe znj. Albina Avdiu, kryesuese e komitetit për Komunitete, e cila do të jetë anëtare e Këshillit, pozitë kjo e cila parashihet me Udhëzimin Administrativ përkatës dhe që ka kaluar edhe përmes Kuvendit të Komunës.

Temat:

### 1. Raporti i Policisë së Kosovës për gjendjen e sigurisë në komunë

- Informatë nga përfaqësuesi i KFOR-i për sigurinë në komunë
- Informatë nga përfaqësuesi i FSK-së për sigurinë në komunë

**z. Bekim Zogiani**, theksoi, situata e gjendjes së sigurisë vlerësohet e qetë dhe stabile, nuk ka ndonjë informacion për tendenca të prishjes së rendit dhe qetësisë publike në përmasa të mëdha. Raste të zakonshme krahasuar me periudhën e njëjtë vitit të kaluar kemi 25 % më pak. Në periudhën korrik-gusht dhe këtë pjesë të muajit shtator të vitit të kaluar kanë qenë 322 raste të evidentuar, ndërsa në periudhën e njëjtë të këtij viti 258 raste. Prej rasteve më shqetësuese janë rastet e dhunës në familje, ku krahasuar me periudhën e vitit të kaluar ka ngritje bukur të madhe të këtyre rasteve. Vitin e kaluar, për periudhën e njëjtë kanë qenë të evidentuara 34 raste, ndërsa tani në të njëjtën periudhë janë 60 raste. Faktorët të cilët po ndikojnë në këtë kategori të veprave penale janë persona me probleme mendore, kushtet e dobëta ekonomike, etj. Sikurse jeni në dijeni, më 25 shtator ka filluar fushata parazgjedhore dhe Policia ka një rol të veçantë në monitorimin e kësaj fushate. Sipas vlerësimit gjithçka është duke shkuar në rregull pa ndonjë problem të evidentuar, po ashtu jemi duke përgatitur edhe planin operativ për ditën e zgjedhjeve dhe pas zgjedhjeve. Sa për njoftim, kemi pranuar 17 zyrtarë të ri policorë të cilët janë sistemuar në Stacionin Policor në Podujevës, gjë që ka ndikuar dhe është relaksuar pak mungesa e zyrtarëve, detyrat më lehtë po realizohen.

**Përfaqësuesi i KFOR-it**, theksoi, jemi një ekip i ri, ka dhjetë ditë që kemi ardhur dhe do të qëndrojmë këtu 6 muajt e ardhshëm. Jemi duke u përgatitur për vëzhgimin e fushatës parazgjedhore, për monitorimin e tubimeve të mëdha por edhe për ditën e zgjedhjeve, pra jemi në suazën e përgatitjeve tona.

**z. Naim Bajraktari** gjatë periudhës verore kemi pas disa intervenime sa i përket aspekteve të sigurisë, njëri ka të bëjë me kërkim shpëtim në ujëra që ka ndodhë në liqenin e Batllavës në muajin gusht, ndërsa operacioni tjetër, është aktiviteti ku Njësitet tona të specializuara të deminimit kanë bërë pastrimin e mjeteve të pashpërthyer në fshatin Lupç.

### 2. Propozim Plani operativ lokal (2019-2020) sipas Strategjisë për parandalimin ekstremizmit të dhunshëm që shpie në terrorizëm (2015-2020)

**z. Agim Blakçori**, theksoi, në funksion të zbatimit të Strategjisë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm që shpie në terrorizëm (2015-2020) ne si grup punues kemi zhvilluar punëtori për hartimin e draftit. Drafti është hartuar mbi bazën e një Plani të mëparshëm operativ që e kemi pasur për periudhën 2016-2018. Mbi bazën e objektivave sipas Strategjisë kemi bërë përpjekje që të përfshijmë në plan një mori të veprimeve dhe masave duke planifikuar edhe personat përgjegjës për realizimin e veprimeve, do të përpiqemi për identifikimin e institucioneve tjera që do të mbështesin në arritjen e këtyre objektivave, si dhe periudhën kohore të planifikuar se kur do të realizohen.

### 3. Informatë për gjendjen e pyjeve

**z. Vezir Januzi**, theksoi, kam përgatitur një informatë të përgjithshme. Pyjet janë pasuri kombëtare dhe nuk është çështje e vetëm e ekonomisë pyjore, e 12 rojeve të pyllit që kujdesen për 30,000 ha pyje sa ka Komuna e Podujevës, por është përgjegjësi e të gjithëve të interesohemi dhe t'i mbrojmë. Një bashkëpunim i mirë i ndërsjellë në mes mekanizmave institucional dhe qytetarëve ka ndikuar në masë të madhe që këto dukuri negative, të shëmtuara në pyje kanë



filluar të zvogëlohen. Është me rëndësi të potencohet se nuk kemi burim alternativ të ngrohjes dhe si burim të vetëm kemi vetëm drurin, dhe si rezultat atakohen pyjet në masë të madhe, por DBPZHR është duke u kujdesur dhe mbikëqyrë procesin e pajisjes së qytetarëve me leje përkatëse për prerje të pyjeve dhe mundohemi që pyjet të prehen në mënyrë të kontrolluar. Sigurisht se pyjet do të prehen derisa shteti të gjejë një burim alternativ për ngrohje, por jemi duke punuar që kjo të bëhet në mënyrë kontrolluar. Për fat të mirë këtë vit kemi pas zjarre vetëm në stinën e pranverës së hershme, 11 raste ku kanë përfshirë një sipërfaqe prej 26.10 ha. Mendoj re mekanizmat relevante por edhe qytetarët kanë punuar në këtë drejtim. Kemi një rënie të dëmtimit të pyjeve. Edhe numri i fletëparaqitjeve tregon se ka rënie të prerjes së druve në terren. Deri më tani janë ngritur 235 fletëparaqitje për kundërvajtje, prej tyre 14 si raste penale dhe 221 kundërvajtëse. Në bashkëveprim me Policinë kemi arritur të konfiskojmë një sasi të madhe të druve në terren prej 282.18 m<sup>3</sup>, sasi kjo, e duke përfshirë edhe atë që është konfiskuar nga viti i kaluar, janë shitur 315 m<sup>3</sup> dru përmes Zyrës së Prokurimit, me ç'rast janë inkasuar të hyra buxhetore në shumë 16005.00 €.

**z. Bekim Zogiani**, theksoi, situata në gjendjen e pyjeve ka ndryshuar në aspektin pozitiv. Ne si Stacion Policor në takimet që kemi pasur me mekanizmat relevant kemi kërkuar që secili nga këndi i vet të kontribuoj dhe kjo ka rezultuar pozitivisht.

**z. Qefser Behrami**, theksoi, javën që shkoi, patëm një mbledhje të KLSB-së dhe pikërisht u diskutua çështja e personave të pandërgjegjshëm që janë duke dëmtuar pyjet. Sa i përket zjarreve në rajonin tonë nuk ka pasur asnjë rast.

**z. Vezi Januzi**, deri sot nga Drejtoria komunale janë lejuar 193 leje për prerje të pyllit, ndërsa prerja bëhet në sasi konformë lejes dhe realizohet me fletë përcjellje dhe damkë pyjore.

#### **4.Masat parandaluese kundër dukurive negative (përdorimi i narkotikëve, vjedhjet, dhuna etj.)**

**z. Agim Blaçori**, ne si DA në kuadër të masave për parandalimin e dukurive negative, ne fokusimin e kemi në fuqizimin e organeve qeverisëse udhëheqëse profesionale të shkollave. Organet e shkollave bashkërendojnë punët dhe aktivitetet për të krijuar një mjedis më të sigurt dhe të shëndetshëm. Kohët e fundit shkollat kanë arritur të formojnë shumë ekipe dhe klube brenda përbrenda shkollës e që kanë ndikim qoftë në shoqërimin e nxënësve mes tyre qoftë edhe drejtpërdrejtë në angazhimin e tyre siç janë p.sh. ka raste të dhunës ku kanë intervenuar dhe kanë arritur t'i ndërmjetësojnë. Fokus tjetër ne si DA dhe shkollat më saktësisht kemi çështjen e përmbajtjes programore, ku një pjesë e këtyre përmbajtjeve ushtrojnë ndikim drejtpërsëdrejti në luftimin e këtyre dukurive negative, sidomos në lëndën e edukatës qytetare etj. , lëndë e cila ka përmbajtje të caktuara që ndikojnë në vetëdijesimin dhe edukimin e nxënësve për rrezikun që mund të paraqesin këto dukuri. Përveç këtyre rol të rëndësishëm luan edhe Këshilli pedagogjik – psikologjik i shkollës, që aktualisht është në disa shkolla dhe varësisht mundësive planifikojmë të zgjerojmë edhe në shkollat tjera. Kemi një bashkëpunim të mirë me Policinë e Kosovës por edhe me organizata të ndryshme në ofrimin e ligjëratave të cilat luajnë një rol të madh në vetëdijesimin e nxënësve. Policia e Kosovës po luan një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm me policët e angazhuar pran shkollave ku po arrijnë të identifikojnë personat e dyshimtë, janë duke u ndihmuar Drejtorëve të shkollave por edhe shoqërisë në përgjithësi. Sipas mundësive do të ishte mirë që ky numër i policëve të rritej dhe të jenë prezentë pran çdo shkolle, sidomos këtu në qendër, ku ka prezencë më të madhe. Në takime gjithashtu ka prezantuar dhe Drejtori i Drejtorisë së Inspeksionit lidhur me inspektimet dhe kontrollat e lokaleve pran shkollave. Në këtë aspekt kemi pasur edhe aksione ku kanë marrë pjesë inspektorë komunal dhe zyrtarë policorë, gjë që

kanë ndikuar dhe është një tregues se mbarëvajtja në shkolla është në përcjellje dhe monitorim, uroj që këto të vazhdojnë në funksion të sigurimit të një ambienti më të sigurt.

**z. Bekim Zogiani**, theksoi, kemi bërë planin për tema të caktuar nëpër shkolla. Ditën e djeshme kemi mbajtur ligjëratat për trafik që u zhvillua për ciklin e klasave të I-V, në teori dhe praktikë. Sipas planit të veprimit, ne që sot do të koordinohemi për ligjëratat në fushën ekstremizmit dhe radikalizmit në kuadër të sigurisë së përgjithshme, janë planifikuar ligjëratat për dhunën në familje, ngacmimet seksuale, përdorimi i narkotikëve dhe dukurive tjera të rrezikshme, këto aktivitete do t'i koordinojmë por gjithherë duke pasur parasysh që mos tu shkaktojmë ngarkesë nxënësve. Kam një kërkesë për Drejtorinë e Inspeksionit për nevojën e organizimit të kontrolleve më të shpeshta të lokaleve rreth shkollave.

**z. Zaim Thaçi**, theksoi, kemi marrë pjesë në ligjëratat të caktuara në shkolla, mjekët kanë ofruar profesionalizmin e tyre për luftimin e dukurive negative si duhanin, alkoolin, narkotikët etj. Mendoj se ligjëratat për vetëdijësim të nxënësve duhet vazhduar, apo përmes kampanjave të ndryshme. Kur është çështja të trajtimet dhe identifikimet e tyre dua të përmend një detaj, në kolegjiunin e profesionistëve shëndetësor është ngritë kjo çështje ekskluzivisht të punëtorët e QPS të cilët së bashku me policinë janë të involvuar në rastet e tilla.

**z. Faik Muçiqi**, theksoi, mendoj se masat parandaluese kundër dukurive negative nuk duhet shikuar ngushtë vetëm në aspektin e shkollave, por duhet më gjerësisht. Fjala vjen vjedhjet në territorin e komunës tonë janë të ndryshme, si të pusëtave, ndriçimit etj, çka do të thotë se janë vjedhje individuale ose grupe të organizuara dhe si rezultat ka fare pak të arrestuar prej tyre. Nëse ne nuk i izolojmë grupet e organizuara kriminale dhe shqiptimin e dënimeve ndaj tyre atëherë kot flasim për arsimimin, edukimin, sepse grupet që i shtyjnë janë jashtë këtyre aktiviteteve të edukimit.

**z. Bekim Zogiani**, sa i përket rasteve të cilat e dëmtojnë shoqërinë tonë në përgjithësi, në periudhën raportuese korrik-shtator 2018 raste ndaj pronës kanë qenë të raportuara 57, ndërsa në periudhën e njëjtë të këtij viti ka një rënie prej 24 raste. Rastet e vjedhjeve të rënda 54 kanë qenë në periudhën e cekur 2018, ka rënie në 33; raste të lëndimeve të lehta –rrahje nga 24 kanë rënë në 19; rastet e lëndimeve të rënda trupore nga 4 kemi vetëm 1 rast; rastet e kanosjes nga 21 kanë rënë në 13; rastet e armëmbajtjes nga 9 kanë rënë në 8 raste; tentim vrasje 1 rast; ndërsa armë të konfiskuara gjatë kësaj periudhe kanë qenë 16 më 2018 dhe 15 në periudhën e njëjtë 2019. Këto rënie janë rezultat i angazhimit të njësisve policore në plane të ndryshme operative. Sikurse keni qenë të njoftuar gjatë sezonit veror, konkretisht në kohën kur diaspora ka qenë më e pranishme cak kanë qenë vjedhjet nga veturat e tyre dhe kjo jo vetëm në Podujevë por disa qytete tjera kanë qenë cak i një grupi i cili ka bërë vjedhje nga veturat. Është arritur që përmes dëshmimeve të arrestohet grupi dhe 11 vepra penale të vjedhjeve janë dokumentuar. Kemi arritur të arrestojmë edhe një person në kryerje të veprës penale ku gjatë asaj nate janë thyer katër lokale dhe i njëjti është arrestuar gjatë thyerjes së lokalit të pestë. Kjo ka ndodhur dy muaj më herët ku janë dokumentuar edhe rastet tjera të mëhershme të vjedhjeve jo vetëm në Podujevë por edhe në Prishtinë. Gjithashtu tani jemi në zbatim të një Plani operativ nga një Njësi me rroba civile që po patrullon gjatë natës.

#### **4. Të ndryshme**

**z. Nexhmi Rudari**, sikurse përmendi Komandanti nga dita e djeshme jemi zyrtarisht në fushatë zgjedhore dhe është përgjegjësi e secilit prej nesh që të krijojmë një klimë të mirë, të qetë që kjo fushatë të përfundoj mirë. Kuptohet Policia ka një Plan të veprimit por edhe ne individualisht por edhe si institucion duhet të japim kontributin në mënyrë që fushata zgjedhore të përmbyllet në mënyrën më të mirë të mundshme.

## **Mbledhja e pestë, mbajtur më 04 nëntor 2019**

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Agim Veliu, Kryetar i Komunës.

Temat:

### **1. Raporti i Policisë së Kosovës për gjendjen e sigurisë në komunë**

- Informatë nga përfaqësuesi i KFOR-i për sigurinë në komunë
- Informatë nga përfaqësuesi i FSK-së për sigurinë në komunë

**z. Bekim Zogiani**, gjatë kësaj periudhe raportuese i kemi të evidentuara gjithsejtë 85 raste të ndryshme. Si çështje më shqetësuese gjatë muajit tetor ka qenë dukuria e shfaqjes së zjarreve në një numër bukur të madh. Dje gjatë ditës ka qenë një zjarr në fshatin Metehi ku ka intervenuar Shërbimi i Zjarrfikësve por edhe Policia. Kërkoj nga të gjithë që të përkujdesemi për ruajtjen e kësaj pasurie. Nga të dhënat dhe informatat e grumbulluar rezulton se faktori njeri është shkaktari kryesor i këtyre zjarreve.

### **2. Informatë për sigurinë në shkolla dhe masat për ngritjen e sigurisë**

Kryetari për shkak të angazhimeve autorizoi Nënkryetarin e Komunës z. Nexhmi Rudari për vazhdimin e mbledhjes.

**z. Agim Blakçori**, theksoi duke u bazuar në raportet e Policisë së Kosovës, raportet e shkollave dhe të DKA-së mund të themi se gjendja e sigurisë në shkolla në Komunën e Podujevës është e qetë dhe stabile, konstatim të cilin e përforcon mbarëvajtja e tërë procesit mësimor në të gjitha nivelet e arsimit në Komunën e Podujevës. Gjatë këtij viti në Komunën e Podujevës janë zhvilluar disa projekte në ndërtimin e infrastrukturës shkollore, siç janë: përfundimi i punimeve në ndërtimin e objektit të shkollës “Dituria” Llapashticë e Poshtme; punimet në ndërtimin e shkollës “Emin Duraku”, në fazën përfundimtare; etj. Drejtori informoi edhe për punët në përmirësimin e infrastrukturës në disa objekte shkollore, pastaj për instalimin e kamerave në disa prej shkollave me numër më të madh të nxënësve, për sigurimin e transportit të nxënësve që kanë distancë mbi 4 km nga shtëpia në shkollë, si dhe për fëmijët me nevoja të veçanta, në gjithë territorin e Komunës së Podujevës, pastaj për projektin e Dezinsektimit, Dezinsektimit dhe Deratizimit(DDD), në të gjitha objektet shkollore. Drejtori gjithashtu foli për organizimin e garave shkollore komunale në futboll dhe volejball, pastaj për ndërtimin dhe rregullimin e trotuareve në drejtim të shkollave. Nënvizoi, në këtë rast do kërkoja nga Drejtoria e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit që gjatë planifikimeve për ndërtimin e trotuareve të vazhdojë t’u jep përparësi rrugëve që shpijnë për në shkolla. Ndër të tjera foli edhe për rolin e organeve qeverisëse –udhëheqëse dhe profesionale të shkollës në zhvillimin dhe ngritjen e cilësisë në arsim por edhe për sigurimin e një mjedisi të sigurt në shkolla. Nënvizoi, sa i përket bashkëpunimit DKA nga Policia e Kosovës ka mbështetje të vazhdueshme në të gjitha aktivitetet ku është e nevojshme, si (organizimi i garave, testeve, mbrëmjeve, shëtitjeve e ekskursioneve etj.) gjatë periudhës 2018/2019.

Si kërkesë për policinë që të vazhdohet me patrullime të rregullta në afërsi të shkollave edhe gjatë vitit shkollor 2019/2020, sidomos te shkollat e mesme të larta.

**z. Bekim Zogiani**, sa i përket bashkëpunimit të Policisë me Drejtorinë e Arsimit mund të them se kemi një bashkëpunim shumë të afërt, mirëpo janë disa çështje që duhet të trajtohen dhe për të

cilat ndjejmë shqetësim. Javën e kaluar kemi arrestuar tre nxënës, njëri ka pas një armë, ndërsa dy të tjerë thika. Kërkoj nga drejtori i DA dhe nga të gjithë drejtorët e shkollave që kontrollet e nxënësve të jenë më të shpeshta dhe ne jemi të gatshëm t'i përkrahim në mënyrë që mos të kemi ndonjë rast të lëndimeve apo me fatalitet.

**z. Qefser Behrami**, theksoi, disa persona ndoshta të pa vetëdijesuar dhe të pakulturuar herë pas herë janë duke penguar procesin mësimor në shkollën e fshatit Kërpimeh duke bërë vozitje me një motor shumë të zhurmshëm. Për këtë kam njoftuar Komandantin e Policisë për çka i jam shumë mirënjohës për punën dhe angazhimin e tij.

### **3. Informatë për sigurinë në komunikacion**

**z. Bekim Zogiani**, sa i përket sigurisë në komunikacion në Komunën e Podujevës në përgjithësi mund të vlerësojmë se gjatë muajit tetor, periudhës së raportimit, kemi pasur 10 aksidente të komunikacionit, krahasuar me periudhën e njëjtë të viti të kaluar ku kemi pasur 15 aksidente, pra me 41 % rënie. Në periudhën tetor 2019 janë shqiptuar 850 gjoba të trafikut, ku një numër bukur i madh i tyre janë për parkime jo të rregullta, që krahasuar me periudhën e njëjtë 2018 kanë qenë 449, d.m.th. 89% kemi të shqiptuara më shumë. Gjatë periudhës janar-tetor 2018 kanë qenë 4712 gjoba të shqiptuara, ndërsa në periudhën e njëjtë të këtij viti 5589 d.m.th. 18% ngritje. Sa i përket aksidenteve në trafik krahasuar me periudhat kohore, i kemi 148 aksidente në vitin 2018 dhe 150 në vitin 2019. Persona të lënduar kanë qenë 22 në vitin 2018, ndërsa në 38 në vitin 2019 gjatë periudhës janar-tetor, etj. Në përgjithësi jemi duke dhënë maksimumin sidomos tani edhe me angazhimin e policëve të rinj dhe qytetin e kemi në prioritet.

**z. Durim Salihu**, theksoi, kemi përgatitur një raport janar-shtator 2019. Bazuar në kompetencat dhe obligimet ligjore që ka Drejtoria e inspeksionit, konkretisht sektori për komunikacion një prej prioriteteve tona në bazë të planit të punës, kërkesave të qytetarëve dhe bashkëpunimit me Policinë e Kosovës në terren prioritet i kemi dhënë mbarëvajtjes dhe kontrollimit të të gjitha lejeve që janë pajisur qofshin personat fizik qoftë juridik. Fokusi ynë ka qenë mbarëvajtja e orarit, siguria e automjeteve që ushtrojnë transportin e udhëtarëve në përgjithësi. Kemi bërë kontrolle të shitësve ambulantiv të cilët janë të lejuar rreth pajisjes së dokumentacionit për transport, kështu që në total ne i kemi bërë 796 inspektime, prej të cilave kemi shqiptuar 117 gjoba të ndryshme, kemi konfiskuar 62 automjete për shkak të parkingjeve në hapësirat e ndaluara për parking, gjithashtu kemi parashtruar 62 kërkesa për kundërvajtje në Gjykatë. Për Drejtorinë e Inspeksionit sikurse u theksua më herët shqetësuese mbetet zënia e trotuareve. Kohën e fundit më tepër u është dhënë prioritet gjobave se sa konfiskimit të automjeteve, por mendoj se duhet vazhduar prapë edhe me konfiskimin e automjeteve, e kam fjalën për automjetin merimangë, ajo shumë pak shihet në terren. Gjobat janë shqiptuar ndaj parkimeve ilegale dhe shqetësim tjetër është edhe çështja e vendparkingjeve të automjeteve të udhëtarëve, konkretisht e kemi një pjesë të rrugës te rreth rrotullimi që lidhë rrugën për në fshatin Kërpimeh, gjithashtu është edhe kryqëzimi i rrugës te marketi Viva Fresh, te pjesa jugore e Komunës që lidhet me fshatrat, jemi në koordinim edhe me Drejtorin e Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit dhe Drejtorin e Drejtorisë Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit që të bëjmë një peron apo parking të përkohshëm në kohë prej 2-3 apo 5 minuta.

**z. Faik Muçiqi**, dua të kontribuoj në këtë pikë pasi që ndërlidhet me disa çështja, fillimisht me pajisje me leje pune për operatorët e transportit. Në fillim të vitit kemi bërë një listë të të gjithë operatorëve, janë pajisur ata që kanë pasur leje gjatë viti 2018. Gjatë viti 2019 nuk kemi pasur operatorë të rinj.

Vitin e kaluar kanë qenë 12 autobus, 20 me minibus, 23 me kombi linje, tre operator të radiotaxi me leje pune dhe që u është vazhduar e njëjta, ndërsa autotaxi numri i tyre ka qenë 25. Problem tjetër është mungesa e hapësirave, Stacioni i autobusëve nuk ka një hapësirë të mjaftueshme për të gjithë operatorët. Në rrugën Sfeçël-Shajkoc në segmentin më të rrezikshëm që kemi vlerësuar kemi ndërtuar trotuare në dy drejtimet për shkak të udhëkryqit që është jashtëzakonisht i rrezikshëm.

## **Mbledhja e gjashtë, mbajtur më 02 dhjetor 2019**

Në mungesë të Kryetarit të Komunës z. Agim Veliu, mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës.

Temat:

### **1. Raporti i Policisë së Kosovës për gjendjen e sigurisë në komunë**

- Informatë nga përfaqësuesi i KFOR-i për sigurinë në komunë

- Informatë nga përfaqësuesi i FSK-së për sigurinë në komunë

**z. Bekim Zogiani**, sa i përket gjendjes së sigurisë gjatë kësaj periudhe raportuese në muajin nëntor 2019, në përgjithësi kemi një situatë të qetë, mirëpo e ngarkuar me aktivitete të ndryshme. Kemi të evidentuara gjithsejtë 100 raste që krahasuar me periudhën e njëjtë nga viti i kaluar ku kanë qenë 106 raste kemi një rënie të numrit të tyre. Rastet që kanë shënuar rënie dhe që janë më shqetësuese për policinë janë shkaktime të rrezikut të përgjithshëm, i kemi 4 raste të evidentuara që krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit nuk ka pas asnjë rast, të cilat janë kryesisht gjuajtjet me armë. Një rast më shqetësues është sulmi në shtëpinë e një zyrtari policor në fshatin Dumnicë, i bërë më datë 28 nëntor në ora 18.30, arsyeja ende nuk dihet, procedura është në vazhdim e sipër. Prej anës policore janë marrë masat për sigurinë e policit dhe të familjes së tij. Sa i përket rasteve tjera më shqetësuese ka qenë numri i aksidenteve, 16 me 6 krahasuar me periudhën e njëjtë të viti të kaluar, 5 persona me lëndime edhe përkundër aktiviteteve gjegjësisht numrit të fletëparaqitjeve, ku janë shqiptuar 868, ndërsa vitin e kaluar 368, në periudhën e njëjtë, dmth një dyfishim, mirëpo prapë ka numër të madh të aksidenteve, e që është një shqetësim bukur i madh për gjithë, jo vetëm për policinë. Kur kam marr informacion për tërmetin në Shqipëri, që është ndier edhe në Kosovë, menjëherë kam kontaktuar Drejtorin e DSHPMSh, Shërbimin e Zjarrfikësve që të koordinohemi dhe të merremi fillimisht me evidentimin se a ka pas ndonjë pasojë, ku fatmirësisht nuk ka pas.

**Përfaqësuesi i KFOR-it**, theksoi, siç po raportohet gjendja e sigurisë në Komunën e Podujevës është e qetë dhe stabile. Ju falënderoj për bashkëpunimin që autoritetet lokale e kanë me KFOR-in. Gjithashtu e vlerësojmë dhe çmojmë solidaritetin ndaj Republikës së Shqipërisë për shkak të tërmetit dhe ky është një shembull i mirë që duhet ndjekur.

**z. Zaim Thaçi**, theksoi, ne si DSHMS me marrjen e informatave të para për ardhjen e personave dhe familjeve nga Shqipëria për shkak të tërmetit kemi filluar aktivitetet tona për identifikimin e familjeve, për numrin dhe nevojat e tyre. Nga të dhënat zyrtare rezulton se të ardhurit janë vendosur në 5 lokacione, prej tyre 3 familje në Podujevë, 2 familje në Hotelin Iliria, 1 familje në fshatin Shajkoc, 4 familje në fshatin Lupç i Epërm dhe 3 familje në fshatin Majac, në numër prej 48 anëtarësh, prej tyre 18 janë fëmijë. Jemi munduar për t'i identifikuar kërkesat dhe nevojat e tyre, u kemi bërë kontrollë edhe në aspektin shëndetësor me një ekipe mjekësor. Prej tyre ka pacientë edhe me sëmundje kronike, një prej tyre është edhe insulinë varës, u kemi siguruar mbështetje shëndetësore 24 orësh. Në vizitë te familjet e vendosura në fshatrat Lupç i Epërm dhe

Majac kemi identifikuar se ato kanë nevojë edhe për mbështetje materiale, për artikuj themelor ushqimor dhe higjenik. Kemi kontaktuar dhe bashkëpunuar edhe me organizatën Kryqin e Kuq dhe ata janë përgjigjur pozitivisht. Në disa raste disa familje i kanë siguruar strehim por gjithashtu kanë kërkuar edhe për t'i mbështetur materialisht. Për banorët e vendosur në fshatrat Lupç dhe Majac sot iu kemi drejtuar me shkrim Agjencionit të Pyjeve për të na lejuar që t'i furnizojmë me një sasi të masës drusore, të cilën masë e kemi në dispozicion por se lëvizja e tyre nuk mund të bëhet pa ndonjë dokument përcjellës, shpresoj se do të na kthejnë përgjigje gjatë ditës, përkundër asaj nëse brenda ditës nuk e gjejmë ndonjë donator privat për të kryer furnizimin me dru. Nga aspekti social mendoj se deri diku kemi arritur të menaxhojmë situatën.

**z. Nexhmi Rudari**, në kuadër të numrit të banorëve u përmend se 18 janë fëmijë, duhet të kemi informacione të çfarë moshe jenë, cilit nivel të shkollimit i përkasin dhe menjëherë të fillojmë përgatitjet që ata fëmijë t'i integrojmë në procesin e rregullt mësimor nëpër shkolla, sepse nëpër këtë përvojë kemi kaluar vet dhe nuk do të doja që ata fëmijë për periudhën sa qëndrojnë këtu të shkëputen nga procesi mësimor. Do të ishte mirë që menjëherë Drejtori i Drejtorisë së Arsimit të siguroj të dhënat e fëmijëve/nxënësve, e kjo me qëllim që mos t'i lëmë këta fëmijë të shkëputur nga procesi mësimor sepse pastaj pasojat janë më të mëdha.

**z. Osman Kurtolli, theksoi**, unë vullnetarisht kam pranuar një familje nga Shqipëria.

Ajo është një familje prej 3 anëtarëve dhe unë menjëherë i kam lajmëruar në Komunë, mirëpo askush nuk ka ardhur për t'i vizituar, nuk është interesuar askush. Aty janë duke qëndruar 2 gra me një fëmijë i cili është i sëmurë, me terapi të gjatë. Për atë familje jam duke u kujdesur vet. Unë i kam lajmëruar për arsye të se duhet lajmëruar, e jo për ndihmë materiale. Në fshatin Shajkoc i kam të lajmëruara 22 shtëpi në dispozicion për të ardhurit nga Shqipëria. Kam formuar një komision dhe kam konstatuar se prej tyre 8 shtëpi janë të banueshme, ndërsa të tjerat jo. Komisioni komunal duhet të ketë informacione për të ardhurit dhe për nevojat e tyre. Si kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame ndihem shumë keq për situatën në Shqipëri sepse ne jemi vëllezër dhe duhet të reagojmë. Bashkësia Islame në Komunën tonë ka grumbulluar rreth 15,000 € ditën e premte, ndihmë për të prekurit. Ndërmarrja ime ka intervenuar me 11 automjete kombi për dërgimin e ndihmave për të prekurit dhe ato janë dërguar në qendrën e grumbullimit.

**z. Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës**, theksoi, për familjet që kanë shprehur dëshirë për t'i strehuar dhe ndihmuar familjet nga Shqipëria është për çdo lëvdatë, megjithatë duhet të vërehet dora e institucionit. Secili kryetar i fshatit ku janë të vendosura familje nga Shqipëria do duhej me shkrim të njoftonte Komunën lidhur me numrin e familjeve apo anëtarëve të strehuar në zonën e tyre. Në këtë mënyrë ne do të mund të menaxhojmë më mirë situatën dhe t'u dalim në ndihmë dhe të sigurohemi për gjendjen e siguris. Kryetari mbajti takimin e Shtabit të krizës ku u dhanë orientimet. KKSB pikërisht ka këtë funksion, koordinimin e aktiviteteve në mes akterëve të ndryshëm dhe jo vetëm të sigurisë, por edhe të tjerëve. Të jemi koshient, të marrim masat në mënyrë që mos të na ndodhë ndonjë problem, duhet të jemi syçelë dhe të dimë saktë se kush është në territorin e Komunës, kush janë dhe nga kanë ardhur dhe të bëjmë verifikimin përmes qendrave të autorizuar.

**znj. Donjetë Sheqiri**, theksoi, sikurse jeni në dijeni më datën 27 kemi marrë një aksion humanitar për solidarizim, për t'i ndihmuar të prekurit nga tërmeti në Shqipëri dhe aty janë lajmëruar familje të shumta të cilat kanë ofruar strehim për familjet e prekura

**z. Faik Muçiqi**, theksoi, në takimin e Komitetit Komunal për Mbrojtje dhe Shpëtim kemi trajtuar këtë çështje. Zyrtarët komunal kanë dalë në terren, unë kam një raport edhe pse nuk është i plotë por është i mirë dhe ky duhet t' i shërbejë edhe Policisë dhe për këtë duhet t'i falënderohemi Policisë, Drejtorisë së Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, Drejtorisë së

Shëndetësisë, Drejtorisë së Arsimit por edhe të tjerëve. Besoj ka edhe persona tjerë që kanë ardhur mirëpo edhe pritja ka shkuar në mënyrë individuale.

**z. Nexhmi Rudari**, duhet vlerësuar shumë lartë punën që është bërë në Komunën e Malishevës që kanë strehuar dhe vazhdojnë të strehojnë refugjatë të përkatësive rome nga Republika e Shqipërisë, andaj ne si Komunë duhet të jemi shumë të vëmendshëm që kushdo që vjen nga Shqipëria, çfarëdo nacionaliteti që janë apo të besimit fetar duhet ndihmuar, sepse nëse ne nuk i shohim njerëzit në aspektin human atëherë edhe ajo e mirë që u bëhet është gjysmake.

**z. Zaim Thaçi**, Familjet të strehuara në fshtat Lupç dhe Majac, pronarët e atyre shtëpive u kanë ofruar vetëm objektin e banimit pa kurrfarë kushtesh tjera dhe ato janë barrë e jona, pra nëse përzgjidhen familjet që kanë shprehur gatishmërinë për lëshimin e objekteve të vijnë në shprehje ato që janë në gjendje t'i mbulojnë të gjitha shpenzimet. Fjala vjen për dy familjet e vendosura në Hotelin "Iliria" nuk kemi kurrfarë obligimesh, përveç vizitës shëndetësore që ua kemi bërë, apo te familja e strehuar në shtëpinë e z. Osman Kurtolli.

## **2. Informatë për rastet e kthimit dhe integritit të qytetarëve në shtëpitë (pronat) e tyre.**

**z. Liman Zeqiri** gjatë vitit 2019 në Komunën tonë janë riatdhesuar 103 persona, prej tyre 60 janë familjarë ndërsa 40 janë kthyer si persona individual. Nga numri i cekur 19 janë nxënës të shkollave fillore dhe të mesme të cilët integrohen në procesin mësimor, sipas procedurave të parapara. Familjet të cilat kanë pas nevojë për ndihmë emergjente 3 familje kanë përfituar strehim të përkohshëm, 2 familje kanë përfitua trajtime mjekësore dhe medikamente përmes Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, 2 familje kanë përfituar pakon dimërore dru zjarri, 3 familje kanë kërkuar që të hynë në skemë sociale. Ne bashkëpunojmë edhe me shumë ojq, sidomos ato ndërkombëtare, duke veçuar ato nga Gjermania, për t'i ndihmuar.

## **3. Formimi i Grupit Punës për Planin e Punës 2020**

### **Formimi i Grupit për Informatën për punën e KKSB për 2019**

Konstatim: Ngritet Grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së KKSB-së për vitin 2020 dhe për përgatitjen e Informatës për punën e KKSB për 2019, në përbërje:

- 1.Faik Muçiqi
- 2.Bekim Zogiani
- 3.Osman Kurtolli
- 4.Donjetë Sheqiri
- 3.Agim Blakçori

**Podujevë, shkurt 2019**

### **Grupi punues**

Faik Muçiqi  
Bekim Zogiani  
Osman Kurtolli  
Donjetë Sheqiri  
Agim Blakçori